

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 6397 rep.

Nr. _____ kol.

202011



**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
DIGICOM SHPK**

Sot me date 25.07.2014, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht Zj. ANISA SKENDAJ, shtetase shqiptare, lindur me 17.12.1984, ne Tirane, e bija e Marselit dhe Veres, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtese e pasaportes nr. SF 0069972, person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe Z. Marin Gjonaj, shtetas shqiptar, lindur me 30.08.1985, ne Tirane, i biri i Besnikut dhe i Brixhildes, banues ne adresen Rr. Nikolla Lena, Nr. 42, Tirane, mbajtes i pasaportes NR. BB8195890, te cilt themelojne sot nepermjet ketij akti nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe dispozitave te parashikuara me poshte.

I.

Krijimi

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DIGICom Shpk." (me poshte e quajtur "Shoqeria"), themelohet ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

II.

Objekti i shoqerise

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne veçanti:

1. Sherbime ne fushen e komunikimeve elektronike si :

- a. Operator I rrjetit dhe sherbimeve per transmetim te dhenash/internet
- b. Operator I rrjetit dhe sherbimeve per telefoni publike te qendrueshme (telefoni fikse)
- c. Sherbime te transmetimit te te dhenave
- d. Sherbime te linjave me qera
- e. Sherbim telefonie me karte te paraguar,
- f. Sherbim Voip
- g. Sherbime te trasnmetimit te te dhenave (data)

A

h. IP TV

2. Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme te huaja ne teritorin e shqiperise sipas autorizimeve perkatese te pajisura prej tyre,
3. Perfshirja dhe ofrimi i perzgjedhjeve per tendera apo kompani me natyre telekomunikacioni,
4. Shkollime per te interesuarit me ose pa eksperience ne fushen e Teknologjise se avancuar,
5. Aktivitete import exportit te makinerive e pajisjeve te fushes se telekomunikacionit,
6. Import exporte per mallra te ndryshme per nevoja te ushtrimit te aktivitetit te shoqerise,
7. Ndermjetesime dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera,
8. Ne pergjithesi, kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale apo transaksioni me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme qe lidhen me objektin e lartpermendur te shoqerise.

III.
Selia

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen:

- Rruga Dervish Hima nr. 1, AdaTower, Tirane, Shqiperi.
Shoqeria mund te hape dege dhe zyra dhe/ose te kryeje aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

IV.
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

V.
Ortakët Themelues

Ortakët themelues jane:

-Z. Marin Gjonaj, shtetas shqiptar, lindur me 30.08.1985, ne Tirane, i biri i Besnikut dhe i Brixhildes, banues ne adresen Rr. Nikolla Lena, Nr. 42, Tirane, mbajtes i pasaportes BB8195890, zoterues i 60% te kuotave te Shoqerise.

-Zj. ANISA SKENDAJ, shtetase shqiptare, lindur me 17.12.1984, ne Tirane, e bija e Marselit dhe Veres, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtese e pasaportes nr. SF 0069972, zoterues i 40% te kuotave te Shoqerise.

VI.
Kapitali Themeltar



Kapitali themeltar i Shoqerise do te jete 1,000,000 Leke (nje milion) i ndare ne 100 (njeqind) pjese me vlere nga 10,000 (dhjete mije) Leke secila.

I gjithe kapitali themeltar do te nenshkuhet dhe do te shlyhet ne para nga Ortaket.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar.

Pergjegjesia e ortakeve per humbjet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

VII. **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga Z. Marin Gjonaj, shtetas shqiptar, lindur me 30.08.1985, ne Tirane, i biri i Besnikut dhe i Brixhildes, banues ne adresen Rr. Nikolla Lena, Nr. 42, Tirane, mbajtes i pasaportes BB8195890. Administratori i Shoqerise do te qendroje ne detyre deri ne momentin e shkarkimit te tij.

Veprimet e administrimit te Shoqerise perpara te treteve do te konsiderohen te vlefshme nese jane ndermarre dhe nenshkruar nga Administratori i saj. Administratori i Shoqerise ka te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer çdo veprim dhe akt ne kuader te aktivitetit te Shoqerise.

VIII. **Pergjegjesia Personale**

Pasuria e ortakut, administratoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve te Shoqerise, eshte e perjashtuar nga çfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine.

IX. **Viti ushtrimor**


Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 5 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

U lexua, u aprovua, u nënshkrua nga ortakët themelues, sot me 25.07.2014, duke autorizuar Z. Enea Gjoka, për të aplikuar dhe regjistruar Shoqërinë në Regjistrin Tregtar Shqiptar në QKR..



Marin Gjonaj



Anisa Sheudor

Une Noteri i Dhomes se Notereve Tirane, ia lexoj me ze te larte tekstin e ketij akti Zj. Anisa Skendaj dhe Z. Marin Gjona, per identitetin dhe per cilesine e te cileve mora dijeni nga dokumentet personale, te cilet njihen me permbajtjen e ketij dokumenti dhe pasi e gjejne permbajtjen e ketij Akti Themelimi ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete akt sipas ligjit.

NOTER

Notere
Martinda E. Demollari
K416060404
Rruga "Vase Pasha"
Tel: 269948 Cel: 0682061560

P

